



# Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo



## AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIE ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIE  
ANTI-CORRUPTION AGENCY



DATË/A:	08.11.2018	Dep. Dep.	DPK	Nr Prot Br.Prot	03-03/39302/18
REFERENCË:	AKK- DPKPP /03-03-3890/18	Dep. Nr. I faq		Prot No Data	
PËR/ZA/TO:	z. Bajram KOLGECI, Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit në Universitetin Publik të Prizrenit " Ukshin Hoti "	Broj stranica Nr. pages	04	Datum Date	09.11.2018
CC:	z. Burim BERISHA, Sekretar i Përgjithshëm në Universitetin Publik të Prizrenit " Ukshin Hoti "				
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Shaip HAVOLLI, Drejtëor i Agjencisë kundër Korruptionit		Raport		
NGA/OD/FROM:	Afrim ATASHI, Drejtëor i Departamentit për Parandalimin e Korruptionit				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " <b>Furnizim me 6 kompjuter laptop dhe 7 smartphone</b> "				

Inderuar z. **KOLGECI**,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, nenit 9 (par. 1, nënpar. 1.5.), 16 (par. 2) dhe 21 (par. 3 ) të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, nenit 2 par.3 dhe të nenit 10 të Rregullores nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 01/2014 dhe Rregullores nr. 01/2017, së Punës së Agjencisë kundër Korruptionit, lidhur me tenderin me titull "**Furnizim me 6 kompjuter laptop dhe 7 smartphone**", me nr. të prokurimit:10208-18-8550-136, dhe me nr. të brendshëm: 1020801835136, Agjencia kundër Korruptionit ofron këtë:

## O P I N I O N

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidençuara në lidhje me Tenderin "**Furnizim me 6 kompjuter laptop dhe 7 smartphone**", me nr. të prokurimit: **10208-18-8550-136**, dhe me nr. të brendshëm: **1020801835136**, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr.04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

## Arsyetimi

Agjencia kundër Korruptionit (në tekstin e mëtejmë Agjencia), duke vepruar sipas detyrës zyrtare pas kontrollimit të njoftimeve për konratë që ka bërë në Sistemin elektronik të Prokurimit, me datë 08.11.2018, ka nxjerrë vendim me numër protokoll: ***AKK-DPK-03-03-3890/18***, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull "***Furnizim me 6 kompjuter laptop dhe 7 smartphone***", ***me numër të prokurimit: 10208-18-8550-136, dhe me nr. të brendshëm: 1020801835136***, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Universiteti Publik i Prizrenit "Ukshin Hoti".

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga Sistemi Elektronik i Prokurimit ka analizuar njoftimin për konratë dhe dosjen e tenderit, ku ka konstatuar se Autoriteti kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurën e kuotimit të çmimit, konratë publike të llojit furnizim, me vlerë të vogël në shumë prej 9.900,00 €.

Agjencia, pasi ka analizuar me kujdes njoftimin për konratë, dosjen e tenderit dhe specifikut teknike ka konstatuar se tek rubrika ***III.2.4. Kapaciteti teknik dhe profesional tek kërkesa I është kërkuar si në vijim: Operatori ekonomik duhet të prezantoj kontrata për tri vitet e fundit deri në publikimin e tenderit minimum tri kontrata në shumën prej 15.000,00 euro.*** Kërkesë kjo për të cilën AKK konsideron se nuk është në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për prokurimin publik më saktësisht me nenin 69.

Sipas Legjislacionit në fuqi për Prokurimin Publik më saktësisht në nenin 69 paragrafi 2.1. parashihet se Autoriteti kontraktues mund të kërkoj "listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, duke saktësuar produktet e furnizuara, shumën e konratës, datën dhe pranuesit: (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjeter, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë".

**Autoriteti kontraktues nuk ka të drejtë të bëjë kufizimin e numrit të referencave në vlerën e caktuar. E rëndësishme për Autoritetin kontraktues është që ta vërtetoj se operatorët ekonomik përmblushin vlerën minimale e cila është kërkuar nga ana e Autoritetit kontraktues pavarësisht numrit të referencave. E jo si në rastin konkret ku janë kërkuar minimum 3 kontrata në vlerë prej se 15.000,00 euro.**

Agjencia gjithashtu vëren se tek pjesa e specifikuve teknike për 7 Smartphone Autoriteti kontraktues ka përshkruar specifikat si në vijim:  
**Display: Super AMOLED capacitive touchscreen 16M colors, 5.8 inch, Chipset: Exynos 8895 octa (10mm)-EMEA, CPU: octa-core (4x2.3 GHz Mongoose M2 & 4x1.7 GHz cortex- A53) EMEA, Internal: 64 GB, RAM: 4 GB, Sensors: Iris scanner, fingerprint (rear-mounted) accelerometer, gyro, proximity, compass, barometer, heart rate, SpO2 dhe OS: Android.**

Specifikimet teknike që duhet t'i kenë këto aparate telefonike janë specifikuar nga Njësia kërkuese në atë mënyrë që i përshtatën prodhuesit *Samsung* dhe eliminojnë prodhuesit tjera.

Autoriteti kontraktues më konkretisht Njësia Kërkuese duhet të ketë kujdes dhe t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të mos janë me vlera fikse, por të caktohet minimumi i kërkeseve teknike dhe që të janë të hapura për të gjithë operatorët ekonomik të cilët mund të bëjnë furnizimet e tilla. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikkime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik apo prodhues të caktuar në treg.

Duke vepruar në këtë mënyrë Autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 7 dhe 28 të Ligjit në fuqi për prokurimin publik në Republikën e Kosovës.

**Në nenin 7 paragrafi 1** në mënyrë decidive thuhet se “Autoriteti kontraktues do t'i trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”.

**Paragrafi 2** parashevohet se “ Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik ”.

**Paragrafi 3** “pa e cenuar paragrafin e mësipërm, Autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përbledh sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkësë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik”.

**Në paragrafin 4** parashihet se “Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik“.

Ndërsa **paragrafi 2 i nenit 28** parashevohet se “Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikkimet teknike në atë mënyrë që ato të janë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuar drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikkime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik ”.

Si dhe **paragrafi 7** parashevohet se “ Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikkimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi. Pavarësisht nga e mësipërmja, Autoriteti kontraktues mundet, që në kushte të jashtëzakonshme, të hartojë specifikkime teknike ose të bëjë një referim të tillë të veçantë, nëse autoriteti kontraktues në mënyrë të qartë vërteton se, nuk

është e mundur që të përpilojë një specifikim mjaft të saktë dhe të kuptueshëm të lëndës së kontratës përkatëse, në pajtim me paragrafin 3-6. të këtij nenit ose ndryshe; me kusht që, çfarëdo referimi i tillë të shoqërohet me fjalët “ose ekuivalent”.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues, konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi nenin 27 Dosja e Tenderit, nenin 28 Specifikimet teknike, nenin 69 Kapaciteti teknik/profesional të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr.05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092, nenin 20 dhe nenin 26 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tillë nuk duhet lejuar në aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korruptionit rekomandon që të evitojen këto shkelje, përmes njostimit standard për informata shtesë dhe përmirësimin e gabimeve, duke i njostuar Operatorët të cilët e kanë tërhequr dosjen e këtij tenderi.

Po ashtu ju njoftojmë se lidhur me këto të gjetura do të njoftohet Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – KRPP.

Autoritetet kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarrা.



*Me respekt !*